

KUJTON!!!

1

Mekanizmat e të krijuarit të sëmundjes të së nxehshit, manifestimi i saj klinik (fotografi), diagnoza dhe mjekimi (trajtim);

2

Njohja e shenjave të hershme të goditjes të së nxehshit;

3

Ndërmarja e masave përkatëse përfthojje dhe resuscitacion; për simptome të hershme dhe trajtim jashtë spitalor, shikoni pjesën informative përcirkim të goditjes të së nxehshit dhe sëmundje tjera të lehta të së nxehshit;

4

Njohja e pacientëve të rrezikshëm dhe edukim përkatës përsjellje ndaj personë të dobët, si dhe foshnjave poashtu është e rëndësishme;

5

Këshilla për personë me sëmundje kronike (të shmangunit nga eksponimi në të ngrohtë, konsumimi i lëngjeve në mënyrë përkatëse, marrja e barnave);

6

Vetëdijesim për efekte të mundëshme të padashura nga barnat e shkruara dhe adaptimi i dozës.

EDUKONI, KËSHILLONI DHE INFORMONI PACIENTËT PËR:

1

Rëndësinë e përmbajtjes ndaj rekandimeve të dhëna në materialet edukative përpullsinë e përgjithëshmë.

2

Marrja e barnave dhe lëngjeve në pajtueshmëri me rekandimet e mjekut.

3

Për informata më të detajuara ti kontaktojnë shërbimet medicinale dhe sociale, linjat për ndihmë dhe shërbimet urgjente medicinale.



SI KUNDËR VALES TË SË NXEHTIT?

Rekomandime përmjekët amë



MINISTRIA E SHËNDËTESISË



Instituti i Shëndetit Publik të RM



Црвен крст на Република Македонија
Крвqi i kuq i Republikës së Maqedonisë
Macedonian Red Cross

S.O.S. NUMËR FALAS PËR INFORMIM PËR MBROJTJE NGA VALËT E SË NXEHTIT
02 32 21 902 (10 - 18H)

Përmbajtja dhe përpunimi i materialit informativ është e përkrahur nga Organizata botërore e shëndetësisë, Zyra në Shkup

GJENDJE MEDICINALE

- SKUQJE E TË SË NXEHTIT (RASH)
- EDEM I TË SË NXEHTIT
- SINKOPA E TË SË NXEHTIT
- NGËRÇITJET E TË SË NXEHTIT
- SHTERRJA NGA I NXEHTI

SHENJA DHE SIMPTOME/ MEKANIZMA

Papula të vogla të kuqe, të krojturit e fytyrës, qafës, pjesa e sipërme e gjoksit, nën gjitë, ijet dhe pjesa e Scrotumit. Ndikon tek të gjitha moshat por më të shpeshta janë tek fëmijët e vegjël. Mund të paraqitet infekcion me stafilokok. Është pasojë e zmadhimit të të djersit të gjatë kohës të nxehtë dhe me lagështi.

Edemi posaçërisht i ekstremiteteve të poshtme, më shpesh të nyjeve paraqitet në fillim të sezonës të së nxehtit.
Është pasojë e vazodilatacionit periferik i shkaktuar nga i nxehti dhe ndalimi i ujit dhe kripës.

Humbja e vetëdijes për një kohë të shkurtër ose marramanjë ortostatike. Është e zakonshme tek personët me sëmundje kardiovaskulare ose personë të cilët konsumojnë diuretikë edhe atë në periudhë para aklimatizimit. Është pasojë e dehidratacionit, vazodilatimit periferik dhe rikthim venoz të zvogëluar dhe rezulton me autput të zvogëluar të zemrës.

Ngërçe muskulore të dhimbëshme, më shpesh tek duart, këmbët dhe abdomeni; më shpesh paraqiten pas ushtrimeve më të gjata.
Është pasojë e dehidratacionit, humbja e elektroliteve nëpërmjet të djersitjes të madhe dhe lodhjes muskulore.

Etje intenzive, dobësi, parehatshmëri, shqetësim, marramanjë, lodhje dhe kokëdhimbje. Temperatura qëndrore mund të jetë normale, subnormale ose lehtë e hipur (më e vogël se 40°C). Pulsi është i dobët me hipotension postular dhe frymëmarrje të cekët. Nuk ka ndryshim të gjendjes mentale.
Është pasojë e shterrjes të ujit trupor dhe /ose kripës që është rezultat i eksponimit në temperaturë të lartë, nxehtësi të lartë ose shterrje.

MASA TERAPEUTIKE

Skuqja tërhiqet pa ndonjë trajtim specifik. Vendosni patientin në hapsirë me pajisje klimë. Me qëllim të minimizimit të të djersit, rekomandohet larja e shpeshtë dhe veshja e teshave me ngjyrë të hapura. Rekomandohet që vendi i skuqur të mbahet i thatë. Lokalisht mund të përdoren antihistaminikë dhe antiseptikë që të zvogëlohet pakëndshmëria dhe mundësia për infektim sekundar.

Trajtimi nuk është i nevojshëm, edemi më së shpeshti tërhiqet me aklimatizim. Nuk rekomandohen diuretikë.

Vendosni patientin në vend të ftohtë.

Vendosni patientin në pozitë të shpinës dhe ngrini këmbët dhe kërdhokullat që të zmadhohet kthimi venoz
Shkyçni arsyet tjera serioze për sinkopa

Vendosni patientin në vend të ftohtë. Térheqja muskulore dhe masazhë të ndjishme.

Rehidratacion oral me tretje e cila përban elektrolite.

Ndihmë medicinle duhet të kërkohet nëse ngërçet e të nxehtit zgjasin më tepër prej një ore.

Çvendosni patientin në hije të ftohtë ose dhomë me pajisje klimë. Çvesheni patientin, mbuloni me çarshafë të ftohtë dhe të lagët ose stërpikni me ujë të ftohtë dhe nëse është e mundëshme edhe të ventiloher. Pacienti të jetë i shtrirë me këmbët dhe kërdhokullat e ngritura që të përmirësohet kthimi venoz. Filloni hidratacion oral. Nëse nausea pengon hyrjen orale atëherë filloni rehidratacion venoz.

Nëse hipertermija është mbi 39 gradë oC , OSE gjendje e çregulluar mentale, OSE paraqitet hypotension constant mjekojeni sikur me qenë goditje e së nxehtit dhe bartni në spital.